

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rriten denoncimet për dhunë në familje në Maqedoninë e Veriut, dhjetëra viktima ndër vite
ADRESA	https://albeu.com/maqedoni/rriten-denoncimet-per-dhune-ne-familje-ne-maqedonine-e-veriut-dhjetera-viktima-nder-vite/1020280/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 18:51:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 18:47:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e40ecadb72755ded0ec3a2e7b7c50312458296733b3a04b94adc7bea0644c002
TEKSTI	1a6ad572c67dc311270eb295be3312ef7c356b5b7195271d2309cdfa15b04635
PAMJA	f90d629be065b375aa29fe57be86fa528a6c97763c9a250f758f80bc793b76fb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7c694dde28ad690c28fd10845f973dc8d9d2b13707d9aa9a62487cb718c47af8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e177be5550b4bd5f7d602f1900530a2156b51a950cd15b25e46c1bef83200b8c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7c694dde28ad690c28fd10845f973dc8d9d2b13707d9aa9a62487cb718c47af8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rriten denoncimet për dhunë në familje në Maqedoninë e Veriut, dhjetëra viktimë ndër vite



Rastet e dhunës në familje vazhdojnë të jenë të pranishme në buletinet e përditshme të policisë në Maqedoninë e Veriut. Gjatë pesë muajve të parë të këtij viti është shënuar një rritje e numrit të denoncimeve.

Mes njoftimeve të publikuara janë edhe rastet: "Shtatë persona arrestohen për dhunë në familje brenda 24 orëve", "U përpoq t'i vinte flakën shtëpisë – kërcënoi gruan dhe vajzën", "1.70 promilë alkool në gjak – sulmoi gruan" dhe "E përplasi derën me veturë, theu dritaren dhe sulmoi bashkëshorten".

Këto janë vetëm disa prej mijëra rasteve të raportuara. Në një pjesë të tyre, konsumimi i alkoolit përmendet si një prej faktorëve që i paraprin dhunës. Megjithatë, pas çdo shifre dhe titulli qëndrojnë histori konkrete të familjeve, grave e fëmijëve, si dhe viktimë që shpesh kanë jetuar për një kohë të gjatë nën kërcënim dhe frikë.

Të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme tregojnë se në pesë muajt e parë të vitit janë evidentuar 768 vepra penale të lidhura me dhunën në familje. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kjo shifër është rritur me 67 për qind.

Elena Dimushevska, nga Rrjeti Kombëtar për Parandalimin dhe Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, e lidh rritjen e raportimeve me inkurajimin e grave për të denoncuar dhunën.

"Dhuna familjare çdoherë ka qenë në shtetin tonë, por siç po përmirësohen ligjet dhe bëhen kampanja për edukim dhe ngritjen e vetëdijes se dhuna nuk duhet të mbetet në shtëpi dhe se shteti ka përgjegjësi që ta mbrojtë viktimën dhe fëmijët, fillon të pranohet si standard i ri në shoqërinë tonë dhe për këtë arsye numri i paraqitjeve shtohet", deklaroi Elena Dimushevska, drejtoreshë e Rrjetit Kombëtar për Parandalimin dhe Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

Ministri i Punëve të Brendshme, Pançe Toshkovski, ka njoftuar se në trajtimin e rasteve të dhunës në familje do të angazhohen ekipe të specializuara të pajisura me kamera trupore. Sipas Dimushevskës, kjo masë mund të

të fundit /



Partizani vijon rezultatet negative, Florin Bratu pas disfatës në...



Fondi i sigurimeve shoqërore, premtimi për mbështetjen e...



Remitencat nga diaspora arrijnë në 828 milionë euro brenda...



Protestuesja para Kryeministrit: "Mjaft është mjaft! Do ulim...



Vendimi i Kushtetueses mban pezull institucionet e Kosovës



19 shoferë u arrestuan brenda një dite për drejtim të...



Juventusi mposht Atalantën 2-0, Zhegrova asiston në...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

ketë ndikim pozitiv.


"Ajo që mund të jetë pozitive është që edhe vetë zyrtarët policorë do të fokusohen në qasjen profesionale, pasi shpesh marrim ankesa nga gratë të cilat kanë thirrur policinë që, nëse nuk është diçka serioze, dhunë fizike të dukshme, policia di të hyjë në rolin e ndërmjetësuesit dhe ta qetësojë situatën, edhe pse tani kjo rrallë ndodh, por përsëri ndodh", tha Elena Dimushevska, drejtoreshë e Rrjetit Kombëtar për Parandalimin dhe Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

Sipas statistikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga viti 2018 deri në vitin 2025 në Maqedoninë e Veriut janë regjistruar 42 vrasje, 24 tentativa për vrasje dhe 192 raste të lëndimeve të rënda trupore në kuadër të dhunës në familje.

Ndërkohë, vetëm në gjashtë muajt e parë të këtij viti janë raportuar katër vrasje, një tentativë për vrasje dhe shtatë raste të lëndimeve të rënda trupore të lidhura me dhunën në familje, bëri të ditur ministri i Punëve të Brendshme. /Alsat.mk

Shtuar më 20.09.2026 20:47

Tags: [Dhuna në familje](#), [Mpb maqedoni](#)



19 shoferë u arrestuan brenda një dite për drejtim të pakujdesshëm



Mickoski kundërshton ndryshimin kushtetues për bullgarët: Në vend janë...



LSDM ngre dyshime për kontratën 13.2 milionë euro të EVN-së dhe lidhjet e...



Mbulohen shkollat në Strugë, tensionohet situata për mësuesit: Opozita flet...



Nuhiu: Kodi Zgjedhor ka nevojë urgjente për ndryshim, në lojë edhe...



Lista e barnave thelbësore rifreskohet pas një dekade, qytetarët kërkojnë më...



Dimitrievski: ZNAM kërkon një tjetër post zëvendësministri në Qeveri



Arrestohet 65-vjeçari pas aksidentit fatal në autostradën Kumanovë—...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.